

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË
" VALTELINO "sh.p.k.
(ORTAK I VETËM)

Sot, më datë 26.X.1993 si ortak i vetëm , unë i quajtur
Dritan Hoxha, i biri Shyqyriut, lindur më 1968, banues në Tiranë
në Rrg. " Pandi Dardha " pll. 60 ap.12 redaktoj aktin e themelimit
të shoqërisë si më poshtë:

Neni 1

Krijohet shoqëria tregtare e emërtuar " VALTELINO "sh.p.k.

Neni 2

Selia e shoqërisë është në Tiranë në Rrg. " PANDI DARDHA "
" BAR BUFE VALTELINO".

Neni 3

Aktiviteti i shoqërisë është mbi dhjetë vjet dhe mund të
shpërbëhet në çdo kohë .

Neni 4

Aktiviteti i shoqërisë është si më poshtë:

- Hapja dhe shfrytëzimin e lokalit, bar bufe, restorant , kafiteri.
- Tregtimin e artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, bujqësor,
blektoral , fruta perime me shumicë e pakic.
- Tregtim in e mëterjaleve ndërtimor dhe elektrik me shumicë e pakic
Import Export.

ORTAKU I VETËM

DRITAN HOXHA



STATUTI I SHOQËRISË " VALTELINEO" sh.p.k.

(ORTAK I VETËM)

FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqëria private me emërtimin " VALTELINEO" sh.p.k. me ortak të vetëm Z. Dritan Hoxha, i biri Fiqirit, lindur më 1968, banues në Tiranë në Rrg. " Pandi "ardha " pll. 60 ap. 28.

VËND QËNDRIMI

Neni 2

Selia e shoqërisë " VALTELINEO" është aktualisht në Tiranë në Rrg. " PANDI DARDHA " - Bar Valtelino . Shoqëria mund të hapë dhe vënd qëndrime të tjera të dyta , operative, filjale e përfaqsi në të gjithë teritoria e vëndit.

KOHË ZGJATJA

Neni 3

Kohë zgjatja e veprimtarisë ekonomike e shoqërisë është mbi dhjetë vjet dhe mund të shpërbëhte në çdo kohë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË , është përse vijon:

- Hapja dhe shfrytëzimi i lokalit , bar - bufe, restorant , kafiteri.
- Tregtimi i artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, buqësor, bletor, fruta perime me shumicë e pakic Import Export.
- tregtimia e materjaleve ndërtimor dhe elektrik me shumicë e pakic Im. Ex.

Si dhe çdo aktivitet tjetër që vejas ose së bashku me ato të përmëndura më sipër do të ndikojë në zhvillimin e rritjen e shoqërisë.

Neni 5

Shoqëria mund të ndryshojë emrin, vënd qëndrimin si dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë ortaku i vetëm.



KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000lek i formuar më masë të plotë nga ortakët i vetëm .

Neni 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të paksohet sipas vendimeve që merr ortakët i vetëm i miratuar dhe i nënshkruar prej tij

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqëria private " VALTELINO" sh.p.k. deklarohet e krijuar më zbatim të plotë të normave që përmban ky statut dhe ato të legjislativës shqiptare. Shoqëria private " VALTELINO" fiton zotësinë për të vepruar me rregjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë si person juridik dhe ndërson uehtron aktivitetin privat me rregjistrimin në Zyrën e Tatimeve.

Neni 9

Shoqëria ka vulë në emër të saj me përmbajtjen " SHOQËRIA VALTELINO sh.p.k. TIRANË".

Neni 10

Shoqëria private " VALTELINO " sh.p.k; vepron më rregjimin e pronës private dhe merr përsipër vetë të drejtat e detyrimit.

Ajo përgjigjet vetë për detyrimet e saj kontraktore e jashtë kontraktore brenda kapitalit të saj. Ortakët i vetëm bartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e shumës së mjeteve të investuara në shoqëri.

Neni 11

Shoqëria " VALTELINO" është pronë e Z. Dritan Hoxha themelues i saj. Ai merr vendime më zbatim të ligjeve në fuqi dhe sipas këtij statuti të cilat janë të detyrueshme për të gjithë të punësuarit në këtë shoqëri.

Neni 12

Ortakët i vetëm, sipas nevojës që i paraqiten për zhvillimin

zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë , emëron Administrator si dhe nëson puntor të veprimtarive të ndryshme të përmëndura në mesin kat të këtij statuti.

Neni 13

Ortaku i vetëm dhe Administratori i ngarkuar prej tij janë të veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshëm e të jashtzakonshëm të shoqërisë pa asnjë lloj kufizimi. Ata kanë mundësi të kryejnë të gjitha aktet që konsiderojnë të nevojshme për aritjen e qëllimeve të shoqërisë. Ata kanë të drejtë midis të tjerash të blejnë e të këmbëjnë pasuri të lidhen me shoqëri të tjera të vëndit apo të huaja të kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha shteteve private apo shtetërore që kanë të bëjnë me garancitë, ipotekat , kryejnëpunësituteve bankare e financiare veprime deponitimi, kreditimi, pagesa e arkëtim . Në këto raste administratori i ngarkuar ka për detyrë të njoftojë dhe ti japë llogari ortakut të vetëm.

Neni 14

Përfaqsimi i shoqërisë " VALTELINO"sh.p.k. i përket presidentit të saj dhe Administratorit të ngarkuar prej tij. Ata kanë të drejtën e përfaqimit të shoqërisë në organet gjyqësore e gjykimë të oaktëjme e të pushojmë avokat.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 15

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllet më 31. dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo perjudhe ushtrimore administratori nxjerr bilancia kontabël të shoqërisë me rezultatim FITIM HUMBJE , mbështetur në ligje dhe rregulla të mbajtjes së kontabilitetit nga subjektet private përcaktuar nga organet kompetente të sistemit fiskal. Bilanci kontabël miratohet nga ortaku i vetëm i cili vendos për krijimin e fondeve ligjore të ndryshme të nevojshme për zhvillimin e garancisë e veprimtarisë së shoqërisë, di fondia e akumulimit, fondia rezervë etj.

Neni 16

Të ardhurat me to pas veçimit të fondeve ligjore të përmëndura më sipër dhe shlyerjen e detyrimeve diskale i mbesin për përdorim ortakut të vetëm të shoqërisë " VALTELINO"sh.p;k.



SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

Neni 17

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe përfaqësohet nga shkak i humbja e kapitalit, pa mundësi veprimtarie etj. Në këtë rast ortak i vetëm i shoqërisë vendos mbi mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë likuidatorë, këta bëjnë kujdes që shoqëria të likujdojë më parë detyrimet që ajo ju ka personave të tretë fizik e juridik.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 18

Përse nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësisht nga ortak i vetëm si dhe ligjeve përkatëse.

Neni 19

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente ndërsa një kopje mbetet si pjesë përbërëse e dokumentacionit të themelimit të shoqërisë "VALTELINO" sh.p.k.

ORTAKU I VETËM

~~BEKRIAN~~ HOXHA

